



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 22/2021 (JR)
Datë 30.04.2021

Vendim nr. 22 (JR)
Datë 14.05.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 14.05.2024, ditën e martë, ora 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Pelivan Malaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 330, datë 11.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Pelivan Malaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, duke arritur në konkluzionin se:
Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të paraqiten me pamundësi financiare për të justifikuar plotësisht me të ardhura nga burime financiare të ligjshme pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për vitet 2005, 2006, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2015, të pasqyruara balancat negative të fondeve si vijojnë: (i) viti 2005 – balanca negative e fondeve (-) 750.328 lekë; (ii) viti 2006 – balanca negative e fondeve (-) 95.026 lekë; (iii) viti 2010 – balanca negative e fondeve (-) 3.531.315 lekë; (iv) viti 2011 – balanca negative e fondeve (-) 1.192.420 lekë; (v) viti 2012 – balanca negative e fondeve (-) 469.549 lekë; (vi) viti 2013 – balanca negative e fondeve (-) 1.959.261 lekë; dhe (vii) viti 2015 – balanca negative e fondeve (-) 3.612.887 lekë.
Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e krijuara ndër vite dhe ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, çka përbën shkak për shkarkimin nga detyra, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
3. Komisioni, referuar nenit 48, nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 330, datë 11.01.2021, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Pelivan Malaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.*
4. Subjekti i rivlerësimit Pelivan Malaj, në datën 31.03.2021, ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 330, datë 11.01.2021, të Komisionit, duke kërkuar: (i) *Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 330, datë 11.01.2021, të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.* (ii) *Vazhdimin e hetimit administrativ edhe për komponentët e tjerë të procesit të rivlerësimit që kanë të bëjnë me figurën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.* (iii) *Ndryshimin e vendimit nr. 330, datë 11.01.2021, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë.*

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin

e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Pelivan Malaj, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh¹ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, gjykimi i kësaj çështjeje u bë në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh.

III. Situata faktike dhe ligjore

5. Nga aktet e çështjes rezultoi e provuar se Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), me shkresën nr. {***} prot., datë 23.05.2022, i ka përcjellë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vendimin nr. {***}, datë 19.05.2022, me të cilin ka vendosur: *Pranimin e kërkesës dhe miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit, zotit Pelivan Malaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, deri në mbushjen e moshës 70 vjeç.*
6. Në vijim, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.04.2024, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 17.04.2024, KLP-ja ka përcjellë vendimin nr. {***}, datë 17.04.2024, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, me të cilin ka vendosur:
 - a. *Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë për zotin Pelivan Malaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.*
 - b. *Shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 19.05.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit Pelivan Malaj”.*

¹ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 330, datë 11.01.2021, për rivlerësimin e subjektit Pelivan Malaj, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 18.03.2021, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 19.03.2021, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 31.03.2021, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***} prot., datë 31.03.2021, që rezulton të jetë dita e 13-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Pelivan Malaj e ka dorëzuar ankimin e tij në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

- c. *Të njoftohet me këtë vendim zoti Pelivan Malaj, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.*
 - d. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.*
 - e. *U shpall në Tiranë, sot, më datë 17.04.2024.*
7. Më datë 22.04.2024, është paraqitur në Kolegj kërkesa e subjektit të rivlerësimit nr. {***} prot., në të cilën parashtrohet fakti se vendimi nr. {***}, datë 17.04.2024, i KLP-së është marrë bazuar në kërkesën e tij dhe nuk do të ushtrojë ankim ndaj këtij vendimi, duke kërkuar nga Kolegji përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për çështjen, pasi objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.
 8. Trupi gjyqësor i Kolegjit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 22.04.2024, vendosi të pranojë kërkesën² e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancës gjyqësore për të konfirmuar që vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr. {***}, datë 17.04.2024, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, që i përket subjektit të rivlerësimit Pelivan Malaj ka marrë formë të prerë. Për këtë arsye, gjykimi i çështjes u shty për në datën 14.05.2024.
 9. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit për verifikimin e faktit nëse vendimi i sipërcituar i KLP-së kishte marrë formë të prerë, KLP-ja informoi³ Kolegjin se z. Pelivan Malaj, nëpërmjet komunikimit elektronik me këtë institucion, me *e-mail-in*⁴ e datës 20.04.2024, ka konfirmuar se është dakord me vendimin dhe nuk do ta ankimojë në asnjë instancë administrative apo gjyqësore, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit Tiranë informoi⁵ se deri më datë 03.05.2024, nuk rezulton të jetë regjistruar ankim pranë kësaj gjykate nga subjekti i rivlerësimit Pelivan Malaj, lidhur me këtë vendim.
 10. Kolegji, në konsideratë të fakteve të parashtruara më lart, si dhe parashikimit ligjor të nenit 192, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas të cilit: *Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj*, konstaton se vendimi nr. {***}, datë 17.04.2024, i KLP-së nuk është ankimuar nga z. Pelivan Malaj brenda afatit ligjor dhe, për pasojë, ky vendim ka marrë formë të prerë.
 11. Nga sa më sipër, rezulton se në momentin e paraqitjes së ankimit dhe regjistrimit të çështjes në Kolegj, z. Pelivan Malaj e kishte (gëzonte) statusin e magjistratit, pasi ankimin e tij e ka depozituar në Komision më datë 31.03.2021, dhe kjo çështje është regjistruar në Kolegj me nr. 22, në datën 30.04.2021, por në momentin e gjykimit të çështjes, e kishte humbur (mbaruar) atë, si pasojë e vendimit të KLP-së të sipërcituar.

² *Subjekti i rivlerësimit, më datë 19.04.2024, ka përcjellë në Kolegj nëpërmjet adresës elektronike, kërkesën drejtuar trupit gjyqësor, për shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 22.04.2024, me pretendimin se vendimi nr. {***}, datë 17.04.2024, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është një provë e re shkresore dhe e rëndësishme për përcaktimin e statusit të tij si subjekt.*

³ *Shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 08.05.2024, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, drejtuar Kolegjit. 4 Bashkëlidhur shkresës, KLP-ja ka dërguar kopje të njësuar të e-mail-it të z. Malaj, të protokolluar pranë këtij institucioni me nr. {***} prot., datë 22.04.2024.*

⁵ *Shkresë nr. {***} prot., datë 07.05.2024, e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.*

12. Duke pasur në konsideratë situatën faktike dhe ligjore të përshkruar më lart, trupi gjykues analizoi pasojën ligjore që ka sjellë humbja (mbarimi) e statusit të magjistratit për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Pelivan Malaj.
13. Qëllimi i ligjit nr. 84/2016 është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës.
14. Neni 179/b i Kushtetutës, në lidhje me pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, janë dispozitat që kanë përcaktuar rrethin e subjekteve që do t'i nënshtrohen rivlerësimit kalimtar. Neni 179/b i Kushtetutës, në pikën 3 të tij ka parashikuar se: *Të gjithë prokurorët [...] i nënshtrohen rivlerësimit ex officio [...] dhe pika 16 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ka parashikuar se: “Subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës.*
15. Kolegji vlerëson se si pasojë e vendimit nr. {***}, datë 17.04.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Pelivan Malaj, në momentin e shqyrtimit të ankimit të paraqitur prej tij kundër vendimit të Komisionit, ka humbur (mbaruar) statusin e magjistratit, duke mos ushtruar më detyrën e prokurorit dhe, për rrjedhojë, ai nuk bën më pjesë në rrethin e subjekteve që duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë mënyrë, objekti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Pelivan Malaj, është bërë i pamundur.
16. Trupi gjykues vëren se Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 nuk kanë parashikuar ndonjë rregullim të posaçëm për situatën faktike të përshkruar më lart dhe, si pasojë, duhet të zbatohet pika 6 e nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se: *kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.*
17. Në kushtet kur në momentin e gjykimit të çështjes, bazuar në analizën e mësipërme, objekti dhe qëllimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të z. Pelivan Malaj, është bërë i pamundur, trupi gjykues vlerëson se zgjidhja e çështjes mund të bëhet sipas parashikimit të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të titulluar “Pamundësia në objekt apo qëllim”, i cili parashikon se: *Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.*

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, me shumicë votash,

VENDOSI:

Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Pelivan Malaj, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 14.05.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, në vijimësi të qëndrimit të mbajtur nga ana ime në vendimmarrjet e Kolegjit për raste të ngjashme, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit (JR) nr. 22, datë 14.05.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për *përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Pelivan Malaj, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.*

2. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, çështja (JR) nr. 22/2021, datë 30.04.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Pelivan Malaj, nuk gjen mbështetje dhe hapësirë tjetër ligjore, përveçse zbatimin të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, që zbatohet në kushtet e heqjes dorë nga detyra. Këtë bindje ma krijojnë faktet e provuara përgjatë shqyrtimit të çështjes, në mbështetje të akteve të administruara në dosjen gjyqësore, të cilat në tërësinë e tyre, parashtrojnë këtë situatë faktike:

2.1. Subjekti i rivlerësimit Pelivan Malaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, pasi në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ushtronte funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

2.2. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në bazë të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 330, datë 11.01.2021, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Pelivan Malaj, mbështetur në konkluzionet se subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nuk është treguar bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit dhe se, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

2.3. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 330, datë 11.01.2021, të Komisionit, duke kërkuar: (i) *kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 330, datë 11.01.2021, të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;* (ii) *vazhdimin e hetimit administrativ edhe për komponentët e tjerë të procesit të rivlerësimit që kanë të bëjnë me figurën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit;* (iii) *ndryshimin e vendimit nr. 330, datë 11.01.2021, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë.*

2.4. Ndërkohë që çështja (JR) nr. 22/2021, datë 30.04.2021, ishte regjistruar në Kolegj, në pritje të shqyrtimit gjyqësor, KLP-ja përcjell vendimin nr. {***}, datë 19.05.2022, me të cilin kishte vendosur: *Pranimin e kërkesës dhe miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit, zotit Pelivan Malaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, deri në mbushjen e moshës 70 vjeç.*

2.5. Në vijim, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.04.2024, KLP-ja i ka përcjellë Kolegjit vendimin nr. {***}, datë 17.04.2024, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, me të cilin ka vendosur: *Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së*

pensionit të pleqërisë për zotin Pelivan Malaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm [...].

2.6. Subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me këtë vendim të KLP-së, paraqet në Kolegj, më datë 22.04.2024, kërkesën në të cilën shprehet se: *duke shprehur vullnetin tim se ndaj këtij vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili është marrë me kërkesën e bërë prej meje, unë nuk do të bëj asnjë ankim, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative.*

3. Subjekti i rivlerësimit Pelivan Malaj, i cili rezulton i datëlindjes 11.09.1955, duket se ka përfituar nga parashikimet e nenit 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: *[...] Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension [...], kërkesë e cila i është pranuar nga KLP-ja, duke miratuar qëndrimin e tij në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, deri në mbushjen e moshës 70 vjeç. Nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje, KLP-ja i ka njohur subjektit të rivlerësimit të drejtën për të gëzuar statusin e magjistratit deri në moshën 70 vjeç.*
4. Unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kërkesës së dytë drejtuar KLP-së, për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, në fakt, me vullnetin e tij ka hequr dorë nga statusi i magjistratit, ndonëse ishte i shkarkuar nga Komisioni, në pritje për t’u gjykuar në Kolegj. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar zgjatjen e afatit për daljen e tij në pension, dhe kjo periudhë e zgjatur deri në mbushjen e moshës 70 vjeç, për mua si gjyqtare në pakicë, është periudhë që i përket statusit të tij të magjistratit, të miratuar nga KLP-ja, për rrjedhojë, shprehja e vullnetit për t’u larguar përgjatë kësaj periudhe, dëshmon qëllimin e tij për heqje dorë nga ky status. Në rastin konkret, shumica e trupit gjykues duhet ta kishte zgjidhur çështjen nën dritën e dispozitave ligjore që parashikojnë dhe rregullojnë pikërisht institutin e dorëheqjes, në kushtet kur vullneti i pavesuar i subjektit të rivlerësimit konfirmohej me veprime konkludente të ndërmarra prej tij, siç është kërkesa drejtuar KLP-së dhe ajo drejtuar Kolegjit më datë 22.04.2024.
5. Nga ana tjetër, bindjen që çështja duhet trajtuar në kuadër të heqjes dorë nga detyra, e përforcon dhe fakti që pavarësisht se subjekti i rivlerësimit në kohën kur ka bërë kërkesën për qëndrimin në detyrë deri në moshën 70 vjeç, ka qenë në pritje të vendimmarrjes së Kolegjit, rezulton se deri në marrjen e vendimit (JR) nr. 22, datë 14.05.2024, të ketë përfituar pagën në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 62, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që në kushte të tjera, nëse nuk do të kishte bërë kërkesë për qëndrimin në detyrë deri në moshën 70 vjeç, me arritjen e moshës së pensionit, 67 vjeç, nga shtatori i vitit 2022 do të ishte trajtuar me pension pleqërie.
6. Përpos sa më sipër, në kuadër të qëndrimit të mbajtur në çështje të ngjashme të trajtuara në Kolegj, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se vendimmarrja e shumicës ka shkuar përtej parashikimeve të nenit 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që në mënyrë shteruese përcakton se: *Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelit vendos: (a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit; (b) ndryshimin e vendimit të Komisionit; (c) prishjen e vendimit të Komisionit.* Në rastin

konkret, shumica e trupit gjykues vendosi *përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Pelivan Malaj pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur*, pa u shprehur për fatin e vendimit të Komisionit, edhe pse objekt të vendimmarrjes kishte pikërisht *shqyrtimin e vendimit nr. 330, datë 11.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit*, që kishte konstatuar pamjaftueshmëri të konsiderueshme financiare, përpos problematikave të tjera, për subjektin e rivlerësimit Pelivan Malaj, duke anashkaluar kështu interesin publik dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit në tërësi.

7. Sa më sipër arsyetuar, vlerësoj se në çështjen e rivlerësimit të subjektit Pelivan Malaj, shumica e trupit gjykues duhet të kishte analizuar dhe vlerësuar vullnetin e subjektit të rivlerësimit dhe qëllimin që ai donte të arrinte nëpërmjet kërkesave drejtuar KLP-së dhe Kolegjit, pasi kishte përfituar të drejtën për qëndrimin në detyrë deri në moshën 70 vjeç, duke i klasifikuar veprimet e subjektit të rivlerësimit si heqje dorë nga detyra dhe zbatimin për pasojë të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi